

Jeta si Thirrje

Grupi do të bëjë eksperience **thirrje**. Në grup të rinjtë marrin pjesë, sepse me liri i janë përgjigjur **thirrjes** së dikujt: një shoku, një edukatori, një asistenti, për të marrë pjesë në këto takime.

Objektiva: Të rinjtë zbulojnë historinë e thirrjes së tyre dhe pranojnë ftesa nga persona të ndryshëm, për një thirrje të vetme: **atë të Zotit**. Ai troket vazhdimisht në dyert e zemrës së të rinjve, por edhe i lë të lirë të pranojnë thirrjen e tij, Ai propozon por nuk detyron.

Aktiviteti: GJEJ THESARIN

Nëpërmjet kërkimit të thesarit të rinjtë kuptojnë se është e rëndësishme të vihen në kërkim të Jezusit. Secilit nga ne Jezusi i thotë: “Ejani e Shihni”. Dhe ne do ti përgjigjemi me Gëzim kësaj ftese që Ai na bën. Nuk mjafton ta njohim Jezusin, duhet ti shërbejmë, të vihemi në praninë e tij. Për të mbërritur tek vendet ku është i ruajtur thesari, është e nevojshme të kalojmë disa prova. Përpara se të fillohet me gjetjen e thesarit, të rinjve do ju dorëzohet një pjesë Ungjilli:

Ungjilli: THIRRJA E NXËNËSVE TË PARË

Jezusi një ditë ishte në bregun e liqenit të Gjenezaretit e, ndërsa populli po shtyhej rreth tij për të dëgjuar fjalën e Hyjit, pa dy lundra buzë bregut të liqenit: peshkatarët kishin dalë e po lanin rrjetat. Hyri në njërën prej atyre lundrave - në atë që ishte e Simonit - dhe iu lut ta largonte pakëz prej tokës. U ul e, prej lundrës, mësonte turmën.

Kur pushoi së foluri, i tha Simonit: **“Grahi në ujë të thellë e hidhni rrjetat tuaja për të zënë peshk.”**

Simoni i tha: “Mësues, gjithë natën u përpoqëm e nuk zëmë asgjë; por pasi po thua ti, do t’i hedh rrjetat.” Si bënë kështu, zunë një sasi të madhe peshqish - gati po u shqyheshin rrjetat. Atëherë u dhanë shenjë shokëve në lundrën tjetër të vinin e t’u ndihmonin. Ata erdhën dhe i mbushën të dy lundrat aq sa gati u fundosën.

Kur pa Simon Pjetri, i ra ndër këmbë Jezusit dhe i tha: “Largohu prej meje, Zotëri, se jam njeri mëkatar!” Vërtet, për arsye të peshkut që zunë, mbeti shtang prej habitës ai dhe të gjithë të tjerët që ishin me të; gjithashtu edhe Jakobi e Gjoni, bijtë e Zebedeut, bashkëgjuehtarë të Simonit. Jezusi i tha Simonit:

“Mos ki frikë! Tani e tutje do të zësh njerëz.” Ata, si i sollën lundrat në breg, **lanë gjithçka e shkuan pas tij.**

Udhëzime

Përpara se të fillohet me gjetjen e thesarit të rinjtë do te reflektojnë mbi eksperiencën njerzore e të qenurit i thirrur për emër, që është shenjë mirënjoheje, shoqërie, dashurie. Zoti na thërret për emër sepse do të krijojë një marrëdhënie me secilin prej nesh. Të rinjtë do të gjejnë një nofkull (sopranome) me të cilën do të thirren dhe e shkruajnë në një copë letre dhe e vendosin mbi shpinë (sikurse bluzat e sportistëve). Të rinjve u dorëzohet harta e vendeve ku do të shkojnë për të gjetur provat që duhen kapërcyer përveç thesarit. Për të gjetur thesarin mund të shkojnë vetëm atëherë kur kanë kapërcyer çdo provë.

Provat

Prova e parë: konsiston në rindërtimin e frazave të cituara:


7, 1, 6, 7, 2, 2, 2, “4, 7, 2, 3, 3?”

1. Mt 20,31 _ _ _ _ _ /
2. Mk 10,21 _ / _ _ _ _ _ /
3. Gjn 1,29 _ _ _ _ _ /
4. Mt 5,5 _ _ /
5. Gjn 16,20 _ _ / _ _ /
6. LK 9,20 “... _ _ _ _ / _ _ _ _ _ / _ _ / _ _ _ / _ _ _ ?”

1. **Populli** u bërtiti të heshtnin, por ata klithën edhe më tepër: “Zotëri, Biri i Davidit, ki mëshirë për ne!”
2. Atëherë Jezusi **e shikoi** ëmbël, i pëlqeu dhe i tha:
3. Të nesërmen Gjoni e pa **Jezusin** duke ardhur drejt tij e tha:
4. Lum ata **që** janë të butë sepse do ta trashëgojnë tokën!
5. Përnjëmend **po ju** them: kush nuk e pranon Mbretërinë e Hyjit pors i fëmija i vogël, nuk do të hyjë në të.”
6. Po ju - i pyeti atëherë ata – “**kush mendoni se jam unë?**”

Zgjidhja: *Populli e shikoi Jezusin që po ju thoshte “kush mendoni se jam unë?”*

Prova e dytë: Prova e dytë konsiston në realizimin e një palosje të një letre në formën e një anijeje, duke ndjekur udhëzimet. Prova është e kalueshme, vetëm në momentin që secili nga pjesëtarët e skuadrës arrinë të ndërtojë një anije.



Prova e tretë: konsiston në gjetjen e fjalve në skemën e propozuar, dhe me shkronjat e mbetura do të gjeni fjalinë e fshehur: **Peshkatar njerëzish**

p	s	h	p	i	r	t	e	t	j	e
z	e	a	m	e	n	o	e	h	i	t
e	o	s	p	e	s	h	k	i	m	ë
l	s	t	h	e	s	h	i	r	i	t
l	t	h	z	k	t	h	k	r	s	i
t	e	a	i	e	a	i	ë	u	ë	r
a	t	e	r	b	m	t	m	r	t	u
r	r	r	ë	d	n	ë	a	a	j	t
k	r	i	s	h	t	e	r	r	e	m
n	j	e	r	ë	z	i	s	h	r	u
s	a	k	r	a	m	e	n	t	d	l

Krishter
Etje

Zelltar

Lumturitë

Amen
Noehit

Shi

Meshë

Zemër

Oste

Zot

Peshk

Hir

Tim

Shpirt

Ëndërr

Mbret

Peshkim

Sakrament

Thirrura

Drejtësi

Taze

Prova e katërt: Tabu: secili pjesëtarë grupi do të kalojë provën duke gjetur fjalën e duhur pa i përdorur fjalët e specifikuar në letër.

<u>ADAM</u> Eva Burrë Brinjë Parajse Krijim	<u>PARAJSA</u> <u>toksore</u> Eden Adami Eva Kafshët Pemët	<u>NOEHI'</u> Anija Kafshë Çifte Përmytje Shi	<u>ANIJA</u> Noehi Besëlidhje Përmytje Kafshë Mëkatore	<u>PJETJI</u> Apostull Peshkatar Peshk Lundër Rrjeta
<u>ZANAFILLA</u> Libri Bibla Krijimi Noehi Babeli	<u>UNGJILLTARËT</u> Katër Jezusin Jetën Luka Mateo	<u>KRIJIMI</u> Ditë Natë Mëngjes Kafshë Pemë	<u>ALTAR</u> Gurë Ofertë Sakrifice Meshë Bukë dhe Verë	<u>PËRMYTJE</u> ujë anije shi Noehi Kafshë

ZOT Atë Bir Shprt shenjtë I mirë Krijues	ABRAAMI Bari I bindur Udhëtim Shtëpi Tokë	MOISIU Egjypt Shpëtim Deti i kuq Pashkë Urdherimet	URDHËRIMET Dhjetë Rrasa Moisiu Izraeli ligje	JEZUSI Zot Birë Kryq Ringjallje Pashkë
EGJIPTI Faraoni Kleopatra Nili Piramida Mosise	JOZEFI Ëndrra kallinj Mantel Jakobi Vellezër	PASHKË Ringjallje Egjypt Deti i kuq Vezë Pëllumb	GJON PAGËZUESI Elizabeta kusheri Jezusin Kokën Zakaria	BESLIDHJE Marrëveshje Rrasa Firmë Popull Battaglia

Prova e peste: Peshkatarët: Të rinjtë do të kenë në dorë disa kallama peshkimi, me rrallë do të peshkojnë një peshk dhe do ta vendosin në një enë, prova quhet e vlefshme vetëm në qoftë se arrijnë të vendosin në kovë 12 peshq brenda dy minutave.

Prova e gjashte: Të rinjtë do të kërkojnë në hapësirën ku janë disa objekte me emrat e kërkuara.

- Diçka që shndritë
- Diçka të lëmuar (lisho)
- Diçka të ashpër
- Diçka transparente
- Diçka të rrumbullakët
- Diçka të lagësht
- Diçka të parfumosur
- Diçka që mban erë të keqe
- Diçka që shkruan
- Diçka për të parë

Kërkimi i thesarit përfundon në kishë. Nën Altarë, të rinjtë do të gjejnë një kuti që brenda saj ka një aparat fotografik, me të cilin do të bëjnë një foto grupi.
Rimerret përsëri ungjilli i lexuar në fillim për një reflektim të shkurtër.